REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR**

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**SEKTORI JURIDIK**

**Nr.** 4912 **Prot.** **Ballsh, më** 18.09.**2026**

**PROJEKT-VENDIM**

**NR.** 54 **DATË** 18.09.**2026**

**PËR**

**MIRATIMIN E AKORDIMIT TË VLERËS FINANCIARE PREJ 40.000 LEKËSH PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË FUNERALIT TË TË NDJERIT QANI RUSTEM HASANI, QYTETI BALLSH, BASHKIA MALLAKASTËR**

**-KËSHILLIT TË BASHKISË**

Në zbatim të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", ndryshuar, neni 6/b, pika 2 e ligjit nr. 9220, datë 15.04.2004 "Për administrimin e shërbimit të varrimit", VKB-së nr. 12, datë 24.02.2020 "Për Miratimin e Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak", Kërkesës së qytetares Barije Hasani me nr. 3777 prot., datë 20.07.2026, bashkëshorte e të ndjerit,

**PROPOZOJ:**

1. Miratimin e akordimit të vlerës financiare prej 40.000 (dyzet mijë) lekësh për mbulimin e shpenzimeve të funeralit të të ndjerit Qani Rustem Hasani, qyteti Ballsh, Bashkia Mallakastër, i cili ka ndërruar jetë më datë 06.07.2026, ndodhur në kushtet e nenit 6/b, pika 2 e ligjit nr. 9220, datë 15.04.2004 "Për administrimin e shërbimit të varrimit", ku citohet, " *Kur detyrimi sipas pikës 1, të këtij neni, është i pamundur, shpenzimet e shërbimit të varrimit kryhen nga njësia bazë e qeverisjes vendore ku ai është i regjistruar*".
2. Pagesa e vlerës merret përsipër nga buxheti i Bashkisë Mallakastër, artikulli 606, zëri "Fond i veçantë", planifikuar në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë Mallakastër.

Ky vendim hyn në fuqi në bazë të pikës 6, të nenit 55, të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Konceptoi: A.Heqimaj
Pranoi: N.Sakaj
Miratoi: M. Shehaj

**KRYETAR**

**Qerim Ismailaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALLAKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR**
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**
**Sektori Juridik**

Nr 4894 prot.

Ballsh më, 18.09.2026

**PROJEKT VENDIM**

**Nr. 53 Datë 18/09/ 2026**

**PËR**
**MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM (UNDP) DHE BASHKISË MALLAKASTËR PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT : ASKUSH TË MOS MBETET PAS**

Mbështetur në nenin 9, pika 1.2, shkronja "b", të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit me nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e SHqipërisë", i ndryshuar, Draft Marrëveshjes ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkisë Mallakastër për zbatimin e projektit "Askush të mos mbetet pas" dhe anekseve përkatëse, VKM nr. 823, datë 06.12.2006 "Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat ditore"

**PROPOZOJ**

**I.** Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkisë Mallakastër për zbatimin e projektit "Askush të mos mbetet pas".

**II.** Ky projekt vendim shoqërohet me draf marrëveshjen (me ankekset përkatëse) dhe relacion bashkëlidhur.

Konceptoi: Juristi, A.Heqimaj
Pranoi: Përgj, N.Sakaj
Miratoi: Drejtor M.Shehaj

**KRYETAR**

**Qerim Ismailaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALLAKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR**
**NJËSIA E INTEGRIMIT EVROPIAN**

Nr. 4894/1 prot. Ballsh, më 18.09.2026

**RELACION MBI PROJEKT VENDIMIN**
**PËR MIRATIMIN E LETRËS SË MARRËVESHJES ("LM") NDËRMJET PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM (UNDP) DHE BASHKISË MALLAKASTËR PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "ASKUSH TE MOS MBETET PAS" KU UNDP SHËRBEN SI PARTNER ZBATUES**

Projekt –Vendimi i Bashkisë Mallakastër hartohet në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeversjen Vendore ", i ndryshuar, me nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë , Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për të Moshuarit në qendrat ditore, të miratuara me VKM nr. 823, datë 06.12.2006 , Zbatimin e projektit ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkisë Mallakastër me objekt: Askush të mos mbetet pas".

Referuar konsultimeve midis zyrtarëve të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim ("UNDP") në Shqipëri dhe zyrtarëve të Bashkisë Mallakaster ("Pala Përgjegjëse") në lidhje me zbatimin e projektit nr. 01005254, "Askush të mos mbetet pas", Bashkia Mallakastër do të jetë plotësisht përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve me kujdesin dhe efikasitetin e duhur, në përputhje me kalendarin e përcaktuar të aktiviteteve dhe në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj LM.

**Titulli i projektit**: "Shërbime me bazë komunitare për të moshuarit"

**Qëllimi:** Përmirësimi i cilësisë së jetës së të moshuarve dhe rritja e përfshirjes së tyre sociale në komunitet.

**Përshkrimi i shkurtër**

Projekti "Shërbime me bazë komunitare për të moshuarit" synon ngritjen e një qendre ditore komunitare për të moshuarit në Bashkinë Mallakastër, me qëllim përmirësimin e mirëqenies së tyre dhe rritjen e përfshirjes sociale. Qendra do të ofrojë një mjedis të sigurt dhe miqësor ku të moshuarit mund të kalojnë kohën e lirë, të socializohen dhe të marrin shërbime bazë socio-shëndetësore.

Qendra do të menaxhohet nga Bashkia Mallakastër dhe do të ketë si staf një punonjës social dhe një punonjës shërbimi. Në ambientet e saj do të ofrohen aktivitete sociale dhe argëtuese, si leximi i shtypit ditor, lojëra sociale (shah, domino, letra), si dhe organizimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese në bashkëpunim me institucione lokale.

Qendra do të ketë kapacitet për 30 persona të moshuar. Bashkia do të vërë në dispozicion ambientet, të cilat do të rehabilitohen dhe pajisen me mobilje dhe mjete të nevojshme.

**P / Njësisë së Integrimit Europian**
Mirjeta Shehaj

**P / Sektori Çeshtjeve Sociale**
Kleidja Hoxhaj

**Drejtor i Burimeve Njerëzore**
Marjola Shehaj

**KRYETAR**

Qerim Ismailaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR